



Numri i lëndës: 2021:115079  
Datë: 20.08.2021  
Numri i dokumentit: 02106665

PA1.nr.1025/2021

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Shqipe Qerimi, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rezarta Balaj, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit F.S., nga fshati ..., Komuna e Podujevës, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185, paragrafi 3., nën-paragrafi 3.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së të pandehurit, avokatit Xhevat Rama, të datës 3 gusht 2021, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, P.nr.308/2021, të datës 19 korrik 2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 20 gusht 2021, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të të pandehurit, avokatit Xhevat Rama, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, P.nr.308/2021, i datës 19 korrik 2021 (në vijim "*aktgjykimi i ankimuar*"), vetëm sa i përket dënimit të shqiptuar, ashtu që kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, të pandehurit F.S., për shkak të veprës penale për të cilin është shpallur fajtor i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim i pandehuri do ta mbaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në pjesët tjera, aktgjykimi i ankimuar mbetet i pandryshuar.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, me aktgjykimin e ankimuar, të pandehurin F.S. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale të lartcekur dhe ndaj tij për shkak të kësaj vepre penale ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy)

vjetëve, të cilin dënim do ta mbajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Konform nenit 79 të KPRK, të pandehurit F.S. me dënimin e shqiptuar do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 8 qershor 2021 e tutje.

Pas shpalljes së aktgjykimit, të pandehurit F.S. në kuptim të nenit 187, paragrafi 1., nënparagrafët 1.1. dhe 1.2., pikat 1.2.1. dhe 1.2.3., lidhur me nenin 367, paragrafi 1., nënparagrafi 1.1. lidhur me paragrafët 3. dhe 7. Të Kodit të Procedurës Penale (KPP), me aktvendim të posaçëm i është vazhduar paraburgimi deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar.

I pandehuri F.S. është liruar nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale, ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurit ose të personave që ai detyrohet t'i mbështes materialisht.

E dëmtuara L. (H.) S., nga fshati ..., Komuna e Podujevës, nuk ka paraqitur kërkesë pasurore – juridike.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë mbrojtësi i të pandehurit, avokati Xhevat Rama, për shkak të vendimit mbi dënimin, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ta aprovojë ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë, ashtu që ndaj të pandehurit të shqiptoj një dënim më të butë apo aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe çështjen ta kthejë në rigjykim.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.1041/2021, të datës 6 gusht 2021, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të pandehurit, avokatit Xhevat Rama, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës e ka caktuar dhe mbajtur seancën e kolegjit konform nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), në të cilën seancë kanë marrë pjesë i pandehuri F.S., mbrojtësi i tij, avokati Xhevat Rama si dhe e dëmtuara L.S., ndërsa në këtë seancë nuk ka marrë pjesë prokurori i Prokurorisë së Apelit të Kosovës edhe përkundër faktit se është njoftuar në mënyrë të rregullt.

E dëmtuara L. S. gjatë seancës së kolegjit ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale, ndërsa nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të pandehurit, avokatit Xhevat Rama gjatë seancës së kolegjit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë pretendimeve ankimore, ndërsa i pandehuri F.S., ka deklaruar se e përkrah deklarimin e mbrojtësit të tij.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të KPP, konstatoj se:

- ankesa është e bazuar.

Në ankesën e mbrojtësit të të pandehurit, avokatit Xhevat Rama theksohet se i pandehuri ka probleme me shëndetin e tij mendor, i njëjti është në trajtim të vazhdueshëm mjekësor dhe sëmundja e tij është e natyrës së pa shëruar. I pandehuri të dëmtuarën e ka bashkëshorte dhe ata kanë 4 (katër) fëmijë për të cilët kujdesen, mirëpo jeta e tyre ka çrregullime dhe probleme të cilat të njëjtit nuk mund t'i rregullojnë dhe shpesh vije deri tek zënka mes tyre. Në këtë mënyrë, me rastin e shqiptimit të sanksionit penal, gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar sa duhet rrethanat lehtësuese, ndërsa dënimi i shqiptuar është mjaft i rëndë, duke pasur parasysh edhe faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, është penduar para gjykatës dhe duke premtuar se në të ardhëm nuk do të kryej vepra tjera penale. I pandehuri dhe e dëmtuara prapë do të jetojnë së bashku, andaj mbajtja e një dënimi të tillë do të ndikojë mjaft keq në raportet në mes tyre dhe tek fëmijët. Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, i pandehuri i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës si më lart.

Edhe pse ndaj aktgjykimit të ankimuar nuk është paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare shqyrtoj aktgjykimin në fjalë edhe në këto drejtime dhe konstatoj se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të pandehurit.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës pretendimet ankimore të të pandehurit janë të bazuara, për faktin se dënimi me burgim i shqiptuar ndaj të pandehurit F.S. nga gjykata e shkallës së parë është me të vërtetë dënim i ashpër, duke i pasur parasysh rrethanat e rastit konkret. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit i ka nënvlerësuar rrethanat lehtësuese, në njërin anë, kurse në anën tjetër nuk i ka marrë për bazë disa rrethana tjera lehtësuese të cilat si të tilla kanë ndikim në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjithashtu, edhe rrethanat rënduese nuk janë vlerësuar si duhet, pasi që dashja nuk është dashur të trajtohet si rrethanë rënduese, për faktin se një gjë e tillë konsiderohet element i figurës së veprës penale. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit F.S., i ka marrë për bazë vetëm këto rrethana lehtësuese : faktin se i pandehuri në shqyrtim fillestar e ka pranuar fajësinë dhe gjendjen e dobët ekonomike. Ndërsa, si rrethana veçanërisht rënduese, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar përgjegjësinë penale të të pandehurit për veprën penale e cila është kryer me dashje, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, siç është jeta dhe shëndeti trupor i njeriut, me ç'rast është ushtruar dhunë psikike dhe fizike ndaj bashkëshortes së tij në orët e vona të natës, duke i zgjuar fëmijët nga gjumi, si dhe duke krijuar shqetësim dhe trauma për të ardhmen e tyre. Gjithashtu, si rrethanë tjetër rënduese është marrë për bazë edhe fakti se i pandehuri është recidivist, pasi që edhe më parë ka qenë i dënuar me burgim për vepra penale të natyrës së njëjtë të kryer ndaj të dëmtuarës së njëjtë, ku me atë rast në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar janë paraqitur numrat e lëndëve, veprat penale dhe dënimet që janë shqiptuar ndaj të pandehurit. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konsideron se gjykata e

shkallës së parë është dashur që me rastin e matjes së dënimit të marrë për bazë si rrethana lehtësuese edhe cilësitë tjera personale të të pandehurit dhe atë faktin se i njëjti është baba i katër fëmijëve, për të cilët edhe duhet të kujdeset, se i pandehuri ka premtuar se nuk do të përsërisë më vepra të tilla penale dhe gjendjen shëndetësore të të pandehurit. Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, si dhe duke e pasur parasysh edhe rrethanat tjera personale dhe familjare të të pandehurit, pastaj raportet e tij me palën e dëmtuar, si dhe premtimin e të pandehurit që në të ardhmen nuk do të ketë kurrfarë probleme me të dëmtuarën, atëherë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës ka ardhur në përfundim se dënimi me burgim i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë ndaj të pandehurit F.S., është dënim i rëndë. Për këto arsye që u theksuan më lart, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës ka ardhur në përfundim se ndaj të pandehurit F.S., duhet të shqiptohet me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës është i bindur se ky dënim i shqiptuar është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale, me cilësitë personale të të pandehurit, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës është i bindur se me dënimin me kusht të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 38 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart e në bazë të nenit 398, paragrafi 1., nënparagrafi 1.4. të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
Departamenti i Përgjithshëm  
PA1.nr.1025/2021, me datën 20 gusht 2021

Zyrtarja ligjore,  
Rezarta Balaj

Anëtarët e kolegjit:  
Afrim Shala

Kryetare e kolegjit,  
Shqipe Qerimi

Abdullah Ahmeti